



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 21762
Datë: 23/9/2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.9.2024, mori këtë:


V E N D I M

mbi kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve master

- I. Studentët e Universitetit të Prishtinës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve master po që arrijnë kalueshmërinë e 50% të provimeve nga viti paraprak.
- II. Studentët nuk mund t'i nënshtrohen provimeve të vitit të dytë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të parë.
- III. Provimet për studimet master mbahen gjatë afatit të provimeve. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).
- IV. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
- V. Programet e studimeve master përfundojnë me pushimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
- VI. Afatet ligjore lidhur me procedurat respektive nga kërkesa për miratim e projekt propozimit deri te mbrojtja publike e punimit te diplomës master, përcaktohen me rregulloren përkatëse ne fuqi.
- VII. Në rast se kandidati nuk e përfundon punimin e temës së diplomës master më së largu 1 (një) vit nga data kur është lejuar tema nga Këshilli i Fakultetit, mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e afatit për punimin e temës, për periudhë shtesë në kohëzgjatje të njëjtë.
- VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 2/171, datë 28.9.2023.
- IX. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë njësitë përkatëse akademike të UP-së.
- X. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i UP-së dhe vlenë deri në një vendim tjetër.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve fakulteteve;
3. Sekretarëve të fakulteteve;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së.



Kryesuesi i Senatit të UP-së

Prof. dr. Qerim Qerimi - Rektor